



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 4, datë 21.05.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:14

Data e mbajtjes së mbledhjes : 21.05.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Të nderuar këshilltarë! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për Këshillin Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë. Materialet Ju janë vënë në dispozicion nga sekretarja e Këshillit .

Ftoj sekretaren të procedoj me thirrjen e emrave të Këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

34 Këshilltarë në sallë.

Denisa Luarasi: Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.
Po kaloj në leximin e 3 pikave të rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3.000.000 LEKË PËR OBJEKTIN “LIDHJA E ENERGJISË DHE UJËSJELLËSIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM SPITALLË”
Pika 2. Shtese Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUJIN MAJ 2025
Pika 3. Shtese Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT NR. 30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1032, RRUGA “ALEKS KOMNENI” DHE PALLATIN “KASTRATI”, RRUGA “RAMADAN VELIU”, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, TË NDRYSHUAR

Denisa Luarasi: Keni ndonjë koment?
Ok.

Flutura Kasa: E, kisha vetëm një vërejtje.
Është hera e fundit që unë votoj kur pikat vijnë 24 orë para mbledhjes.

Denisa Luarasi: Faleminderit

Jonuz Myshketa: Po. Mundem?

Denisa Luarasi: Po.

Jonuz Myshketa: Doja t'i shkoja asaj që tha kolegja Flutura. Unë e bëra të ditur dhe në çatin që kemi ne si kryesi. Unë nuk kam qenë dakord shtimit të dy pikave sepse bie ndesh me rregulloren dhe është bërë një praktikë e përsëritur që në moment të fundit të shtohen pikat pasi miratohet në Kryesinë e Këshillit. Pra, shkelet rregullorja sepse me rregullore materialet të gjithë këshilltar duhet t'i kalojnë shtatë ditë përpara. Na vjen në moment të fundit, na vijnë disa pika sensitive. Ok. Për pikën e miratimit të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike mendoj që s'ka nevojë as mbledhemi fare sepse që të gjithë biem dakort. Por urgjenca që të futet kjo pikë, urgjencë më e madhe është që të shtohet vlera e ndihmës së familje në nevojë sesa të futet si pikë rishtazi. Dhe për miratimin për pikën numër 3 që do hiqen disa familje të cilat ishin parashikuar të kalonin në fondin e rindërtimit si përfituese, nuk kemi asnjë lloj materiali që ta vlerësojmë këto familje e meritojnë apo nuk e meritojnë. Kështu që më duket nuk di çfarë emri t'i vë kësaj, sepse unë nuk e shoh këshillin bashkiak dhe bashkinë si kolorit politik por e shoh si institucionin më të rëndësishëm të qytetit të Durrësit ku duhet të vendosen disa standarte në radhë të parë përtej politikës dhe të përkthehen në shërbime më të mira për qytetarët. Këtë kisha unë. Dhe unë jam kundër shtimit të dy pikave, e kam shprehur dhe i qëndroj. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Myshketa.
Po, z. Muka.

Ardian Muka: Jemi në një vijë me parafolësit, edhe ne nuk jemi dakort me shtimin e dy pikave. Nuk shoh ndonjë urgjencë, meqenëse si pika 1 dhe pika 3, që i shtohen mund të merren në shqyrtim në seancën e mbledhjes normale që mund ta kemi besoj brenda këtij muaj ose në fillimin e muajit tjetër. Për të njëjtat motive, tani s'po rri ti përsëris. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Jeni dakort ta kalojmë rendin e ditës në votim?
Kush është pro?
Kundra?.....
Abstenim?.....

Dorina Milja : Atëherë 27 pro, 6 kundra dhe 1 abstenim.

Denisa Luarasi: 27 pro, miratohet pa ndryshime.

- Jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Përsëritet të gjithëve!
Komisioni ynë e ka miratuar pikën e parë dhe e propozon sot të kalojë në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave, Tarifave, zotit Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë e kalon këtë pikë për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit z.Xhelilaj.
Komente ose pyetje ka?

Ardian Muka: Po. Po.

Denisa Luarasi : Zoti Muka.

Ardian Muka: Doja një informacion më shumë, meqenëse flitet për një fond 3 milion lekë, pra për lidhjen e energjisë dhe ujësjellësit në Zonën e Re për Zhvillim Spitallë. Pse nuk është parashikuar kjo që është në momentin e parë? Pra kur është hapur tenderi, duhet të jetë në dispozicion të firmave, duhet të ishte në fondin e hapur, pra në momentin e hapjes së tenderit për rindërtimin. Do doja një informacion nga ana e bashkisë : Pse nuk është bërë që në atë moment? Dhe pse na sillet për shtesë tani? Faleminderit.

Denisa Luarasi Faleminderit zoti Muka.
Kemi ndonjë përfaqësues të bashkisë?

Gentian Kallmi : Lorenc.

Denisa Luarasi : Po Lorenc.

Lorenc Facja: Përshëndetje.

Në lidhje me këtë fond rreth 3 milion lekësh për pagesën me lidhjen e energjisë elektrike dhe ujësjellësin në zonën e rindërtimit Spitallë, është parashikuar me fondin rezervë për arsye se ky investim është bërë nga Eagle Hills dhe nuk është bërë me buxhet të shtetit. Ndërsa të gjithë, sipas kontratës, të gjithë tarifat e pikave lidhje me OSHE-në, kjo është vetëm tarifë pike lidhje me OSHE-n dhe Ujësjellësin. Nuk është lidhje kontratash, që është detyrim i bashkisë dhe i qeverisë shqiptare.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Facja.

Ardian Muka: Pra është shtesë kontraktore, nga kontrata initiale e kemi ne.....

Lorenc Facja: Po e ka bashkia domethënë, në bazë të kontratës që është lidhur me Eagle Hillsin, të gjithë detyrimet për rrjetin e infrastrukturës dhe për lidhje i ka qeveria shqiptare dhe kjo është si detyrimi i joni si bashki, që jemi përfitues të këtyre apartamenteve.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Atëherë kush është pro?

Kalojmë votim.

Jonuz Myshketa: Kisha unë diçka.

Munir Konesha: O kalojmë në votim, o vazhdojmë.

Joniada Musaraj: Kur çelet procesi i votimit...!?

Denisa Luarasi: Votoni.

Dorina Milja : 37 pro.

Denisa Luarasi: Atëherë me 37 miratohet pa ndryshime.

- Jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2** Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit zotit Florian Tahiri.

Florian Tahiri: Përshëndetje të gjithëve!

Atëherë, pika 2 si gjithmonë përsa i përket ndihmës ekonomike kaloi nga anëtarët e komisionit dhe e hedhim për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Tahiri.

Komente kemi?

Atëherë kalojmë votim.

Kush është pro pikës 2?

Kundra ...s'ka

Abstënim ...jo

Me 37 pro miratohet pa ndryshime.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 3** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe në lidhje me pikën 3, komisioni ynë e miratoi dhe e kalon sot për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Pëshëndetje !

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike miratoi pikën 3 dhe e kalon sot për votim në këshill.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

Komente, pyetje kemi për pikën 3?.

Po zoti Muka.

Ardian Muka: Dhe për këtë pikë do të donim një informacion më shumë. Prandaj thashë nga momenti i parë nuk ishim dakort që këto dy pika t'u shtonin në këtë rend dite. Megjithatë informacion më shumë, sepse nga relacioni që na keni dërguar shihet thjesht që përjashtohet dhe përjashtohen emrat e familjeve dhe familjarëve. Nuk shohim një motiv që pse këto përjashtohen. Pra, do donim një koment më shumë. Ka një kazus të përbashkët. Ecët për secilin rast. Ka kritere përjashtuese për këto? Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Zoti Nënkrjetar.

Gentian Kallmi: Përsëndetje!

Atëherë në lidhje me pikën 3 të rendit ditës, arsyet kryesore, dy arsyet madhore janë se pas verifikimeve të bëra nga institucioni i bashkisë në bashkëpunim me ASHK-në dhe gjendjen civile, dy arsyet kryesore siç e përmenda janë dy pronësia në disa raste ose vendbanim i zakonshëm jo në qytetin e Durrësit në raste të tjera.

Ardian Muka: Pra ju po thoni që këto kanë qenë banorë, sepse në godinat që janë shembur dhe janë rindërtuar këto kanë qenë banorë, por ndërkohë i hiqet e drejta e pronës meqenëse kanë dhe një prone tjetër ose këto nuk janë banorë të Durrësit. Kjo është? Ky është motivacioni domethënë?!

Po ku është e shkruajtur në ligj që dikush që ka pasur pronë me rastin e tërmetit, pra ka hyrë në fuqi situata e emergjencës civile, është marrë një vendim që të gjithë do shpronësohen, do rindërtohen apo ato që kanë marrë pjesën e rindërtimit është tjetër gjë. Ku është e shkruajtur në ligj kjo? Përveç atyre VKM-ve të famshme domethënë, që dolën në atë kohë. Po në ligj si mund t'i marrësh t'i heqësh drejtën e pronës, ta rindërtosh gjënë dhe mos t'ia japësh mbrapsht? Thjesht sepse paska një apartament tjetër, por thjesht sepse nuk është banor i qytetit.

Gentian Kallmi: Akti normativ nr. 9 dhe VKM-ja përkatëse i përcaktojnë qartë kriteret kualifikuese për përfitim nga programet e rindërtimit dhe këto kritere që ju sapo përmendët janë kritere s'kualifikuese nga programi i rindërtimit.

Arjeta Keçi : Edhe pse ata janë taksa pagues.

Ardian Muka: Kanë pronë të regjistrueme në hipotek besoj, se pallatet kanë që në të regjistrueme, atyre në momentin që i është shëmbur i jepet të gjithëve, këtyre iu hiqet e drejta e pronës. Nuk jemi dakord, gjithësesi.

Edlira Shemsi : Vetëm ligjet komuniste i kanë zhvesh njerëzit nga pronat.

Denisa Luarasi: Po Joniada.

Joniada Musaraj: Atëherë një sqarim në lidhje me pikën 3, për të sqaruar dhe këshilltarët dhe gjithë kolegët. Këto kritere nuk është se kanë dalë sot, këto kritere kanë qenë në lidhje me banesën e dytë dhe me pashaportizimin të qenurit banor zyrtar i qarkut të Durrësit, dhe duke patur një volum pune, ju me të drejtë thoni pse nuk është kapur në kohë kjo gjë. Duke patur volum pune, dhe ASHK-ja kur të kthen përgjigje, është munduar t'i verifikojë të gjitha këto prona? Dhe sot rezulton që kanë banesë të dytë në qarkun e Durrësit, një pjesë dhe pjesa tjetër e tyre nuk janë banorë të qarkut të Durrësit. Fizikisht janë këtu. Është e vërtetë, por VKM-ja parashikon që këto dy kritere janë përjashtuese dhe kur vjen një përgjigje nga ASHK-ja, normalisht bashkia e Durrësit dhe Këshilli Bashkiak nuk mund të mbyllë sytë dhe kur janë dy kritere përjashtuese t'i përfshijë këto. Të paktën ky është qëndrimi im dhe diskutimi që është bërë në komision.

Dhe në lidhje me mungesën e informacionit është e vërtetë që krahu i djathtë nuk ka informacion, sepse nuk merr pjesë në mbledhjet e komisionit kështu që prandaj dhe nuk e ka. Nënkryetari i bashkisë ishte prezent në mbledhje që bëri komisioni dhe i dha dhe sqarimet në lidhje me pyetjet që ne kishim. Kështu që unë jam e mendimit që duhet të miratohet. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

Faleminderit zonja Musaraj.

Po zoti Myshketa.

Jonuz Myshketa: Më lejoni, më lejoni ju lutem t'ju drejtohem me një fjalë në mënyrë njerëzore si këshilltarë, si qytetarë, si ata që investohen në pronat e familjeve të tyre, në banesat, pra përtej VKM-së. Këtu nuk i kërkohet bashkisë të mbajë përgjegjësi për diçka që s'e ka nxjerrë bashkia. Këtu jam unë i pari që nuk mund t'ia kërkoj atë që s'ka ta tekë bashkia, por jua kërkoj juve si këshilltar. Më duket është realisht një VKM, por është e padrejtë. Po le t'i shohim gjërat në sy si janë. Pse duhet të fshihemi pas VKM-rave kur është diçka, ai person, ato familje që kanë investuar jetën e tyre, mundin e tyre, djersën e tyre me një të rënë të lapsit se pse po mos ndërtoj është diçka tjetër. Prapë ato kanë të drejtën të rikompensohen për pronën, për mundin, për djersën e tyre. Dhe ky është një fakt njerëzor. Po t'i lemë për një moment të zhvishemi dhe nga politika dhe nga të gjitha, ta trajtojmë çështjen në vetë të parë, sikur prekemi ne. A ju duket e drejtë kjo? Nuk mendoj që nga ana njerëzore ju duket e drejtë dhe për anën njerëzore të votojmë njëherë, të bëhemi bashkë për atë ç'ka mund të na prekin nesër neve, sepse ato para avullojnë, ai mund të ikën. Pra unë nuk mendoj të jemi kaq të pandjeshëm, sepse është një VKM, sepse është një një nen që thotë diçka të padrejtë, sepse dhe në 45-ën u shprehen shumë VKM, po ishin të padrejta dhe vazhdojnë me prapë ky, kjo qeveri, ose ky vend vazhdoi të eci me VKM të padrejta dhe ne të rrim mosbëzajmë. Pra ky është mendimi im me një fjalë edhe thirrja im është për të gjithë ju të shkëputemi ta shohim në raport me anën njerëzore të vetes sonë, se cila është më e drejtë. VKM-ja apo qëndrimi apo ajo shumëzimi me zero i gjithë atij mudi. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Myshketa.

Joniada Musaraj: Po vetëm 1 sekond. z. Myshketa.

Denisa Luarasi: Po e ka marrë fjalën zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Po zoti Myshketa po më kërkoni një gjë që unë si juriste nuk e bëj dot dhe as ju nuk e bëni dot. Më kërkoni të dal mbi ligjet dhe mbi VKM-t.

Pra, unë kam si parim si juriste atë që quhet shteti i së drejtës dhe unë eci mbi ligjet, mbi bazën ligjore. Unë vendimet këtu si këshilltare i marr mbi një bazë ligjore dhe shqetësimi juaj nga ana njerëzore unë e kuptoj shumë mirë. Edhe unë e kam, të jem e singertë dhe nuk e kam vetëm për ata, e kam dhe për veten time në radhë të parë si banore e Durrësit, si taksapaguese që tha dhe kolegja, por këtu më kërkohet të mbështetem diku ta justifikoj atë vendimmarrje. Nëse ju sot zoti Myshketa nese më sillni një bazë ligjore që unë ta rrëzoj këtë vendimmarrje, unë jam e para që e rrëzoj, por më duhet baza ligjore, sepse nuk eci dot ndryshe. Jo vetëm në këtë institucion, por në çdo institucion ecet mbi bazë ligjore, po më kërkon diçka që unë nuk e bëj dot.

Dhe në lidhje me atë që ju keni anën njerëzore dhe ne s'e kemi, ju merakoseni për njerëzit dhe ne nuk e kemi. Kjo nuk është e vërtetë. Kjo nuk është e vërtetë, sepse pikërisht se jemi kujdesur të gjithë bashkë për këta persona, ndihma e parë që është dhënë, është dhënë edhe strehimi, është dhënë dhe bonusi i qerasë të gjithë bashkë ne e kemi marrë këtë vendim, por unë të them që një vendimmarrje e tillë në këshillë pa bazë ligjore e ke totalisht të cënueshme. E ke të cënueshme. Nesër, pasnesër është një vendimmarrje e cënueshme, sepse nuk ka bazën ligjore nëse më kupton drejtë. Dhe nga ana tjetër po flasim për një kategori personash që nuk janë të pastrehë. Myshketa nuk janë të pastrehë. Ata figurojnë. Bashkia ka sjellë një relacion të bazuar mbi një informacion që i vjen nga një institucion tjetër. Pra ka një objekt tjetër banimi, me funksion banimi dhe ne jemi të ndërgjegjshëm që këto kritere nuk kanë dalë sot. Kjo VKM nuk është sot. Ne e dimë që kur ndodhi fatkeqësia që këto kritere kanë qenë gjithmonë dhe prandaj janë përjashtuar dhe persona kur ndodhte një verifikim i një banimi apo nuk ishte banor i qarkut të Durrësit.

Pra nëse unë, nuk është sfidë, unë realisht jam e predispozuar për qytetarët bashkë me ty, por nëse më jep një bazë ligjore ku ti bazohesh, unë jam e para që kthej mbrapsht vendimmarrjen time dhe e votoj sot kundër. Por nuk mund të vijë në këshill dhe të marrë vendimmarrje mbi bazën e normave morale, shoqërore që patjetër qëndrojnë, që patjetër dhe ligjet dhe VKM-të kur hartohen mbi bazën e këtyre, por vendimmarrja sot është institucionale, e kupton? Pra është e cënueshme nesër pasnesër. Më thuaj si mund të mbrohem unë nesër në një vendimmarrje të tillë?

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Shkurt t'ia japim pak fjalën zotit Myshketa meqë ju përmend emri.

Jonuz Myshketa: Unë nuk e thashë atë që ju s'e mendoni. Absolutisht jo. Thashë, ju bëj thirrje juve që të gjithëve si qytetarë. Pra të lutem cito drejt, sepse jam munduar nga fillimi deri në fund t'i citoj. E thatë shumë mirë si juriste, formimi im nuk është juridiku, nuk është jurisprudenca, por e thatë shumë qartë që ligjet ndërtohen mbi bazat morale. Ligjet ndërtohen mbi jetën e qytetarëve dhe mbrojtjen e tyre dhe interesave të drejtpërdrejtë qytetarëve. Kemi shumë ligje dhe në emër të ligjit janë bërë shumë padrejtësi. Sot për mua ky ligj është i padrejtë totalisht. Atëherë kjo është ana morale e cila prevalon mbi ligjin dhe e drejta sublime e shpenzimeve e kursimeve e një jete të tërë për shkak të një VKM-je : Mos ta marri kur ndërtohet objekti aty, sepse ka dy shtëpi? Atëherë çdo të thotë kjo? Pra për mua është jashtë, totalisht absurde të gjykohet për shkak të ligjit, sepse ligji mund të jetë i padrejtë. Hajde ta diskutojmë këtu dhe ana morale prevalon mbi ligjin.

Kjo është ajo përgjigjja ime kundrejt asaj dhe do ju lutem të jemi sa më korrekt. Nuk e marr fare për ters, por e quaj si lapsus atë pjesën se nuk akuzoj asnjë këtu. Faleminderit.

Jonuz Myshketa: Faleminderit z. Myshketa.

Joniada Musaraj: Po të flas diçka të fundit. Nuk është, sepse kur në rastin konkret bëhet fjalë për dhënie pronësie dhe normalisht një verifikim i dytë përpara se të jepet të hidhet shorteu dhe të jepen çelsat. Unë jam pro dhe jam partizane e kësaj gjëje që t'i jepet dikujt që e meriton dhe në rastin konkret këto banesa nuk është se nuk do përdoren për t'i ardhur në ndihmë personave të tjerë, por unë jam e mendimit që dikush që ka një pronë të dytë më mirë të mos përfitojë ky person dhe të përfitojë dikush tjetër që është më nevojtar. Pra, nuk është se këto banesa do t'i përdor unë dhe ti. E kupton? Pra të jemi të qartë. Nuk është se këto, po prapë në të mirë të komunitetit do përdoren. Më kupton?

Flutura Kasa: Denisa do vesh një rregull, jo kështu 1-sh, 2-sh.

Denisa Luarasi: Zonja Musaraj?.....Lëre.

Flutura Kasa. Është diskutuar te këshilli paraardhës se po dalim këtu sikur ai këshilli që ka ndenjë kot. Kjo është kërkuar me forcë nga këshilltarët për t'u ndryshuar VKM-ja. Më kupton? Ka shkuar dhe kërkesë në qeveri dhe qeveria e ka mbajtur këtë ligj, që po kërkohet sot. Më kupton? Prandaj është shumë e dhimbshme që hiqen këto shtëpiat, se çdo njeri prek te vetja vetë, por kur ligji thotë kështu, ne s'mund të shkojmë nesër se do japim gjithë llogari për këtë. S'mund ta shkelim dot si ligj.

Po jo se nuk është bërë, se po dalim nganjëherë pavarësisht se nuk e kam me të keq, as me Jonin, po dalim sikur ne jemi kale karroce edhe s'kemi as dhimbshuri as kurrgjë. Thjesht është bërë kjo kërkesë me forcë dhe ti (*..e ka me Denisën..*) ke qenë vetë anëtare e Këshillit të kaluar dhe disa këtu që kjo gjë, kjo kërkesë është bërë, si qytetar e kemi kërkuar.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Kasa.

Kalojmë votim.

Ardian Muka: Jo, më fal

Atëherë unë do të jap dy, dy detaje teknikisht dhe ligjërisht pse ligji, VKM-ja është e jashtëligjshme.

Duroni dy minuta.

..... shumë zhurmë dëgjohet në grup që flasin të gjithë përnjëherë....

Denisa Luarasi: Ta dëgjojmë. Ju lutem. Ju lutem ta dëgjojmë zotin Muka.

Ardian Muka: Kam të drejtën e fjalës 2 minuta, pastaj kam të drejtë dhe qytetarët të informohen. Në ligjin e bashkëpronësisë, në momentin që një person fizik blen një apartament, nuk është vetëm pronar i apartamentit, automatikisht është pronar në pjesën takuese dhe në truall.

Pra, në qoftë se dikush në një pallat, i cili ka 50 apartamente dhe ka një truall 1000 metra katror për pjesën takuese 1/50 pjesë, ai është pronar dhe i truallit. Në momentin që ne i shpronësojmë të drejtën e apartamentit, nuk i shpronësojmë dot të drejtën e truallit. Trualli ngelet aty. Në qoftë se ky pallat është shembur, ai person i cili ka pasur apartamentin sipër gëzon 1/50-n pjesë të truallit.

Automatikisht në momentin që do ndërtohet pallati i ri, është ndërtuar pallati i ri dhe ky nuk trajtohet si pronar trualli për sipërfaqen e truallit që ka pas, neve të gjithë jemi në shkelje të ligjit të bashkëpronësisë. Ai zotëri do i lindi e drejta nesër, e çon në gjykatë dhe do ta fitojë atë apartament.

Pse? Pse duhet neve ta bëjmë dhe të bëjë këtë kalvar persona? Kur ne në princip e dimë që ky ligj kështu si është i ndërtuar, është i ndërtuar gabim. Natyrisht, natyrisht në një regjim diktatorial komunist gjithçka ndodh. Ju lutem, por ju lutem, por ne po i shkelim në të drejtën e tyre të gjithë këtyre personave të cilët e kanë blerë apartamentin dhe janë pronarë. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zoti Muka.

Zonja Meçi kërkoj fjalën.

Klementina Meçi: Atëherë, përshëndetje.

Në fakt nuk marr fjalën për të tilla diskutime, sepse mendoj që ne kemi një fushëveprim të caktuar dhe sigurisht që do duhet ta përballojmë më me dinjitet këtë pjesën çfarë na takon e çfarë s'na takon. Sa një koment shumë të shkurtër në fakt kam unë. Më vjen shumë mirë që jemi në këtë pikë, që nga pika që mbështes Flutrën kur tha në mandatin e shkuar e tjerë e të tjerë, edhe unë si pjesë e mandatit të shkuar e di shumë mirë se çfarë sfidash kemi pasur dhe një ndër sfidat më të mëdhaja edhe publike në fakt, ka qenë diskutimi në po bëhet ose po bëhet gjë për këtë. Dhe më vjen shumë mirë realisht që ne kemi arritur në pikën që e kemi superuar këtë, kemi përballuar situatën dhe tashi diskutojmë përtej nevojës bazike sociale, përtej nevojës imediate të qytetarëve për të patur një një streh mbi kokë. Diskutojmë dhe nevojat e tjera. Pa diskutim që është e shëndetshme, por mendoj që do duhet të rrimë brenda kontureve dhe fushëveprimit të këshilltarëve bashkiakë. Nuk më duket etike që dikush të diskutojë një, të gjykojë, një vendim që do marrim ne sot, ashtu siç nuk më duket etike që ne të diskutojmë një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili është marrë nga organet kompetente. Faleminderit.

Hekuran Markola : Duhet të bëhemi deputet një herë, pastaj të diskutojmë VKM-në, jo këshilltarë.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Meçi.

Kalojmë votim.

Kush është pro pikës 3 të rendit ditës?

Dorina Milja : 27

Denisa Luarasi: Kundër ?....

Dorina Milja : 8

Ti Edlira?

Edlira Devolli : Kundër.

Dorina Milja: Atëherë kundër 9

Edlira Devolli : Sikur s'del numri?

Dorina Milja : Më fal ti Xhojana ishe Pro.

Xhojana Gjineci : Po

Dorina Milja : Atëherë 28 Pro.

Denisa Luarasi : Me 28 miratohet pa ndryshime.

Atëherë nuk kemi kërkesa për diskutim .

Po zoti Tahiri

FlorjanTahiri: Nuk po i hyj pikës 3 edhe pse kisha diçka për të thënë, po doja vetëm një kërkesë. Mirë do ishte të ishte kryetarja, po besoj që Genti do ja përcjelli.

Pata një eksperiencë për sa I përket mungesës. Një karroatrec nga ana e policisë bashkiake që besoj për qytetin tonë, për kushtet, për madhësinë që kemi është e pakonceptueshme mos kemi një karrotrec me ligj. E pra, rasti ishte konkret. Një makinë përpara garazhit të pallatit, një pallat po themi me 20 makina brenda. E la makinën dikush, e parkoi rreth gjashtë orë. Askush nuk mund të hynte, nuk mund të dilte dot nga pallati. Erdhi policia e shtetit, i vendosi një gjobë prej 3.000 lekë të reja dhe kaq. Mora policinë bashkiake, nuk kemi karrotrec. I thashë ta paguaj unë karrotrecin, nuk kam as procedure ligjore, tha për ta. Dhe gjashtë orë çfarë lloj nevojë, halli ne mund të kishim, nuk bënim dot asnjë gjë. Është e pakonceptueshme që bashkia e Durrësit, flasim për turizëm, flasim për qytetin e dytë për nga rëndësia, etj... thashë me një numër policësh bashkiak, besoj që tashmë është goxha i madh në krahasim me disa vite më përpara dhe është e pakonceptueshme dhe në qoftë se nuk është buxheti për ta blerë që besoj që një zgjidhje i gjehet, të paktën me qeranë bëjmë ligjin. Janë të gatshëm qytetarët për këto rastet ekstreme ta paguajnë vetë karroatrecin vetëm që t'i zhblllokohet situata apo raste të tjera ku makinat parkohen në vende të gabuara që realisht prishin qarkullimin apo rendin e qytetarëve. Kështu që të lutem përcjelleni këtë gjë edhe ngrejini si shqetësim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Tahiri.

Atëherë duke ju falenderuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Për mbledhjen e radhës do njoftoheni nga sekretarja e këshillit.

Mirupafshim.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 10 (dhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Drejtuesi i senacës plenare, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i procesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtues i senacës Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak :

DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak:

EDLIRA DEVOLLI

Këshilltar (Kr. Grupi) :

FLORIAN TAHIRI

Këshilltar (Kr. Grupi) :

KONTJANA KUÇI